



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 107, dt.10.05.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 10.05.2016, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për *ing. Florenc Gjiguria*,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve të *ing. Florenc Gjiguria*, për kategorinë AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”, nënkategoritë AZ/2, AZ/3, sipas rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e *ing. Florenc Gjiguria*, me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”, nënkategoria AZ/2, AZ/3.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI